

LegalNews

SPECIAL

June 2021
Qershor 2021



NDRYSHIME DHE SHTESA TË RËNDËSISHME NË KODIN E PROCEDURËS CIVILE

Më 29 maj 2021 hynë në fuqi ndryshimet dhe shtesat më të fundit në Kodin e Procedurës Civile, të parashikuara në Ligjin nr. 44, datë 23.03.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", botuar me Fletoren Zyrtare nr. 71 të datës 14 maj 2021.

Këto risi synojnë rritjen e efikasitetit dhe efektshmërisë në sistemin e drejtësisë nëpërmjet disa rregullimeve procedurale, duke u nisur nga problematikat e hasura në praktikë, nevoja për të garantuar gjykimin brenda afateve të arsyeshme dhe koniukturat e procesit të vetting-ut.¹

Në trajta të përgjithshme ndryshimet dhe shtesat lidhen me:

- Kundërshtimin e vendimeve të gjykatës mbi juridiksionin dhe kompetencën;
- Gjykimin e padive me shuma të vogla;
- Aspekte të shqyrtimit dhe gjykimit në apel;
- Gjykimin për përjashtimin e gjyqtarit;
- Rekursin e veçantë, si dhe shqyrtimin e ankimeve të veçanta
- Aspekte të shqyrtimit dhe gjykimit në Gjykatën e Lartë;
- Gjykimin për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore;
- Procedimet paragjykimore;
- Rregullime kalimtare.

Përmbajtja e këtyre risive ligjore është përmbledhtazi si më poshtë:

a. Kundërshtimi i vendimeve të gjykatës mbi juridiksionin dhe kompetencën

Me ndryshimet e reja ligjore, regjimi i kundërshtimit të vendimeve të gjykatës mbi juridiksionin dhe kompetencën është njëjtësuar me atë të parashikuar në gjykimin administrativ², në dritën edhe të jurisprudencës të Kolegjit Administrativ.

Kundërshtimi i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm në Gjykatën e Lartë lejohet vetëm ndaj vendimit të gjykatës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, duke qenë se mund të cenohet thelbësisht aksesin në drejtësi të personit, ndërsa për vendimin e ndërmjetëm të rrëzimit të kërkesës së palës për nxjerrjen jashtë juridiksionit dhe vendimet mbi kompetencën ankimi i veçantë është suprimuar.

Në këto raste të tjera, kundërshtimi i vendimmarrjes së gjykatës lejohet të kryhet së bashku me ankimin e vendimit jopërfundimtar ose përfundimtar të saj, duke garantuar sidoqoftë kontrollin gjyqësor të tyre.

¹ Relacioni shoqëruar i projektligjit depozituar në Kuvendin e Shqipërisë nga nismëtarët;

² Neni 9 dhe neni 13, paragrafi 2 i Ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

b. Gjykimi i padive me shuma të vogla

Niveli i vlerës së padisë me shuma të vogla për të cilat Kodi i Procedurës Civile parashikon rregulla të posaçme gjykimi është zmadhuar nga 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë në 600 000 Lekë (gjashtëqind mijë)³, duke zgjeruar kështu edhe gamën e çështjeve që do të mund t'i nënshtrohen këtij lloji gjykimi.

Kështu është rregulluar terminologjia e përdorur në pothuajse të gjitha parashikimet ligjore që i bëjnë referencë nivelit të vlerës së padisë për qëllim të rregullave të posaçme të gjyqimit të padive me shuma të vogla.

Por ky nivel nuk është ndryshuar përse i përket vendimeve të gjykatës të apelit për të cilat nuk lejohet rekurs, duke bartur mundësinë e paqartësive në të ardhmen.

Gjithashtu, ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile parashikojnë se në rastet kur vlera e padisë është më e vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi, por vlera e kundërpadisë e tejkalon këtë kufi, atëherë do të prevalojnë dhe zbatohen rregullat e gjyqimit të zakonshëm.

c. Aspekte të gjyqimit në apel

i. Përbërja e trupit gjykues

Ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Civile përcaktojnë se gjykata e apelit do të shqyrtojë më një gjyqtar të vetëm ankimet kundër vendimeve për paditë me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi (paditë me shuma të vogla) dhe që rrjedhin nga:

- marrëdhënie kontraktore, ose;
- ankimet e veçanta kundër vendimit të refuzimit të kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit apo vendimit që ka shqyrtuar kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, si dhe;
- rastet e tjera të parashikuara shprehimisht në Kodin e Procedurës Civile.

ii. Përgatitja e çështjes dhe njoftimi i palëve

Gjykata e apelit njofton palët mbi ditën, orën e gjyqimit dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton çështjen, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së gjyqimit, nëpërmjet ⁴:

- Shpalljes në ambientet e saj dhe në gjykatën përkatëse të shkallës së parë;
- Publikimin në faqen e internetit të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë; si dhe
- Njoftimin individual të palës ose përfaqësuesit në rastin kur kanë lënë të dhënat elektronike në shkallën e parë

³ Ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile parashikojnë si nivel vlerën e njëzetfishit të pagës minimale në shkallë vendi, që aktualisht është 30,000 Lekë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1025, datë 16.12.2020 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi";

⁴ Neni 460 i Kodit të Procedurës Civile;

Në rast se përbërja e trupit gjykues nuk iu njoftohet palëve sipas këtyre rregullave, atëherë palëve iu lind e drejta të kërkojnë shtyrjen e gjykimit, përveçse kur marrin pjesë në gjykim dhe nuk kërkojnë përjashtimin e gjyqtarëve.

Gjithashtu, sikurse në gjykimin administrativ, tanimë palët do të kenë të drejtën për të paraqitur parashtresa me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim, deri në 5 (pesë) ditë para shqyrtimit të çështjes.

iii. Rastet e kalimit në seancë gjyqësore

Krahas rastit kur gjykata çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar nëse duhen marrë apo pranuar fakte ose prova të reja sipas nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile, me ndryshimet e reja, gjykata e apelit vendos kalimin në seancë gjyqësore edhe në rastin kur vë në diskutim çështje të faktit ose të ligjit, për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre.

iv. Shfuqizimi i të drejtës për pezullim

Ndryshimet e reja kanë sqaruar përfundimisht mbivendosjen e kompetencave të gjykatave për pezullimin e vendimit të gjykatës të apelit, duke shfuqizuar kompetencën e kësaj të fundit.

Për rrjedhojë, tanimë pezullimi i vendimit të gjykatës së apelit mund të kryhet vetëm nga Gjykata e Lartë në vijim të kërkesës së palëve dhe sipas kushteve të përcaktuara në ligj.

ç. Gjykimi për përjashtimin e gjyqtarit

Për shkak të problematikave të hasura në formimin e trupave gjykues, ndryshimet e reja përcaktojnë se gjykimet mbi kërkesat e palëve për përjashtimin e gjyqtarit në apel ose gjykatën e lartë do të kryhen nga një gjyqtar tjetër i këtyre gjykatave përkatësisht që është i ndryshëm nga anëtarët e trupit gjykues. Në të dyja rastet vendimi i këtij gjyqtari është i formës së prerë.

d. Ankimet dhe rekursat e veçanta

Me ndryshimet e reja, terminologjia juridike për mjetin e ankimit të veçantë në Gjykatën e Lartë ka ndryshuar duke e riemërtuar si rekurs i veçantë.

Në këtë linjë janë kryer përshtatjet dhe shtesat e nevojshme duke përcaktuar se palët mund të ushtrojnë rekursin e veçantë në rastet e vendimeve të ndërmjetme për të cilat lejohet shprehimisht, si dhe vendimet jopërfundimtare të gjykatës së apelit si:

- Vendimi për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht dhe dërgimin e çështjes për rigjykim;
- Vendimi për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimi i çështjes.

Afati për rekursin e veçantë është 5 (pesë) ditë, njësoj sikurse edhe për ankimin e veçantë.

Gjithashtu, ndryshimet e reja kanë saktësuar dhe plotësuar procedurën e shqyrtimit të ankimeve dhe rekurseve të veçanta.

Kësisoj, rekursitet e veçanta ndaj vendimeve të ndërmjetme do të shqyrtohen njësoj sikurse ankimet e veçanta në dhomë këshillimi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatën e lartë.

Ankimet dhe rekursitet e veçanta ndaj vendimeve jopërfundimtare po ashtu, shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatën më të lartë.

dh. Aspekte të shqyrtimit dhe gjykimit në Gjykatën e Lartë

i. Përgatitja dhe depozitimi i rekursit

Ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile parashikojnë se rekursi duhet të përmbajë dhe saktësojë qartë shkaqet për të cilat kundërshtohet vendimi si dhe argumentet që mbështesin pretendimin se ekzistojnë shkaqe për rekurs sipas parashikimeve të nenit 472 të këtij Kodi⁵.

Rekursi si dhe të gjitha kërkesat e tjera të paraqitura në Gjykatën e Lartë duhet të nënshkruhen nga avokati që kryen përfaqësimin, dhe nëse pala e kërkon nga kjo e fundit.

Risia e shtesave të reja qëndron në parashikimin e një formati jo-detyrues të paraqitjes së rekursit të miratuar nga Këshilli i Gjykatës së Lartë.⁶ Rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin.

ii. Shqyrtimi i kërkesave formale dhe të metave të rekursit

Me ndryshimet dhe shtesat e reja në Kodin e Procedurës Civile synohet t'i jepet fund problematikave të hasura për shkak të paqartësive në parashikimet ligjore mbi autoritetin dhe procedurën e shqyrtimit të përmbushjes së kërkesave formale apo të metave të rekursit.

Tanimë, si fillim shqyrtimi i të metave do të kryhet në dhomë këshillimi nga relatori që ka dhënë vendimin ose gjyqtari i vetëm.⁷

Në rast se rekursi nuk është i plotë apo ka të meta pala njoftohet për plotësimin e tyre brenda 5 (pesë) ditëve. Kur ankuesi nuk plotëson të metat rekursi do të konsiderohet se nuk është paraqitur dhe do t'i kthehet palës së bashku me aktet e tjera; kundër vendimit të gjyqtarit për kthimin e padisë lejohet rekursi i veçantë. Nga ana tjetër, nëse të metat plotësohen brenda këtij afati, rekursi do të konsiderohet i paraqitur që nga data e depozitimit fillestar në gjykatë.

⁵ Neni 472 parashikon si shkaqe për rekurs:
a) zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, të një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore
b) kur vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika gjyqësore e Kolegjit Civil ose praktika e njësuar e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
c) shkelje të rënda procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose procedurës së gjykimit.

⁶ Format i rekursit i miratuar nga Këshilli i Gjykatës së Lartë:
http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Rregullat_e_reja_9967_1.php

⁷ Gjyqtari i vetëm në lidhje me çështjet të cilat gjykohen nga një gjyqtar;

Përveç gjyqtarit të apelit ose gjyqtarit që ka dhënë vendimin, në rast se ky i fundit nuk ka arritur t'i evidentojë, të metat e rekursit mund të konstatohen edhe nga relatori i çështjes në Gjykatën e Lartë, i cili procedon dhe disponon në dhomë këshillimi njësoj sikurse gjyqtari i apelit ose gjyqtari që ka dhënë vendimin. Megjithatë, ndaj vendimit të relatorit në Gjykatën e Lartë për kthimin e rekursit nuk lejohet ankim.⁸

iii. Kufijtë e shqyrtimit të çështjes

Si rregull, Gjykata e Lartë shqyrton rekursin brenda kufijve të tij, përveç kur ligji parashikon ndryshe.⁹

Me ndryshimet e reja parashikohet se në rastet kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit të ngritura prej saj dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor, duhet të kryhet njoftimi i palëve dhe të caktohet afati për depozitimin e parashtresave të tyre në lidhje me këto çështje.

iv. Shqyrtimi i çështjes

Risitë e Kodit të Procedurës Civile parashikojnë se si rregull shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë tanimë do të kryhen mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Përgjegjës për caktimin e datës dhe orës për shqyrtimin e çështjes do të jetë gjyqtari relator i caktuar me short dhe jo më Kryetari i Gjykatës së Lartë. Palët kanë të drejtë t'i kërkojnë më shkrim relatorit përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara. Në çdo rast gjyqtari relator arsyeton përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes.

v. Kalimi në seancë gjyqësore

Meqenëse shqyrtimi kryhet si rregull në dhomën këshillimi mbi bazë dokumentesh, ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Civile parashikojnë shprehimisht rastet në të cilat Kolegji Civil mund të vendosë kalimin dhe shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, që përfshin rastet kur:

- Çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;
- Vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Civil thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës dhe kompleksitetit të çështjes kur 1) vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika gjyqësore e Kolegjit Civil/praktika e njësuar e Kolegjeve të Bashkuara, 2) ka shkelje të rënda procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit/procedurës së gjykimit ose 3) Gjykata e Lartë ka vënë në diskutim kryesisht çështje të ligjit për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre.

⁸ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Llojet_e_rekurseve_9969_1.php

⁹ Neni 473/a i Kodit të Procedurës Civile;

Kolegji Civil disponon me vendim kalimin në seancë gjyqësore si dhe përcakton datën me orën e saj, të cilat duhet t'i njoftohen palëve të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para.

vi. Heqja dorë nga rekursi

Në ndryshim nga më herët kur heqja dorë nga rekursi lejohej derisa nuk kishte nisur relatimi në seancë gjyqësore, tanimë palës i rezervohet kjo e drejtë gjer në momentin kur Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara nuk janë tërhequr për vendim. Forma e heqjes dorë nga rekursi nuk ka ndryshuar dhe vijon të kërkohet me shkrim e nënshkruar nga avokati që kryen përfaqësimin ose vetë pala.

vii. Vendimmarrja e Gjykatës së Lartë

Risitë në Kodin e Procedurave Civile kanë prekur edhe disponimet e Gjykatës së Lartë pas shqyrtimit të çështjes, duke parashikuar se Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara mund të marrin këto vendime:

- Mospranimin e rekursit, në raste kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile;
- Prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
- Prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues;
- Prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë kur vendimi jopërfundimtar i gjykatës të shkallës së parë është marrë në kundërshtim me ligjin dhe kjo shkelje nuk është konstatuar nga gjykata e apelit;
- Prishjen e vendimit të gjykatës të shkallës së parë de të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjyqimit të çështjes;
- Ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe të vendimit të gjykatës së apelit dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes, kur zbatimi i ligjit procedural apo material nuk diktohet nga nevoja për rishqyrtimin dhe rivlerësimin e fakteve apo provave të çështjes.

Pra, krahas vendimeve të mëparshme të mundshme, risitë e Kodit të Procedurës Civile parashikojnë mënyra disponimi të tjera sikurse prishja e vendimeve dhe kthimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë në rast se vendimi jopërfundimtar i kësaj të fundit ka qenë i paligjshëm, si dhe ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta duke zgjidhur përfundimisht çështjen.

Relacioni bashkëshoqërues i projektligjit dhe udhëzuesi i faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë qartësojnë se disponimi i zgjidhjes përfundimtare të çështjes nga Gjykata e Lartë nuk e kthen këtë të fundit në gjykatë fakti, por kufizohet vetëm në zbatimin e ligjit procedural apo material.

viii. Njoftimi i vendimit

Për shkak të problematikave të evidentuara në praktikë në lidhje me njoftimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe në mënyrë që të garantojë të drejtën e ankimit të palëve, ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile parashikojnë shprehimisht që sekretaria gjyqësore njofton vendimet e Gjykatës së Lartë brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e vendimit ose, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet me vonë, brenda 3 (tre) ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar.¹⁰

e. Rigjykimi në apel

Në rast se Gjykata e Lartë dërgon çështjen për rigjykim, në vendim do të duhet të përcaktojë cila pjesë e vendimit ose gjykimit të faktit prishet dhe për cilën pjesë të mosmarrëveshjes duhet të zhvillohet rigjykimi.

Rigjykimi kufizohet detyrimisht vetëm në shkaqet e prishjes së vendimit sipas përcaktimeve dhe kufijve të vendosura nga Gjykata e Lartë.

ë. Gjykimi për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore

Ndryshimet e reja parashikojnë dhe qartësojnë procedurat për gjykimin e njësimin ose ndryshimit të praktikës gjyqësore.

Procedura për njësimin e praktikës gjyqësore vendoset nga Kolegji Civil kryesisht ose me kërkesë të palëve. Ndërsa, procedura për ndryshimin e praktikës gjyqësore mund të vihet në lëvizje si nga Kolegji Civil, ashtu edhe nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

Kolegji Civil ose Kryetari i Gjykatës së Lartë përcaktojnë me vendim të ndërmjetëm çështjen që shtrohet për njësim apo praktikën që shqyrtohet për t'u ndryshuar. Gjykimi për njësimin e praktikës gjyqësore kryhet nga Kolegji Civil me trup gjykues të përbërë nga 5 (pesë) gjyqtarë, në të cilin marrin pjesë trupi gjykues që po shqyrton rekursin dhe dy gjyqtarë të zgjedhur me short; ndërsa gjykimi për ndryshimin e praktikës gjyqësore zhvillohet nga kolegjet e bashkuara sipas rregullave përkatëse dhe me pjesëmarrjen e të paktën 2/3 e të gjithë anëtarëve.

Një risi interesante e ndryshimeve të reja në Kodin e Procedurës Civile lidhet me mundësinë që gjatë gjykimit për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, për shkak të interesit madhor të këtyre gjykimeve, Gjykata e Lartë mund të kërkojë mendim me shkrim nga Avokatura e Shtetit, si dhe nga persona juridikë publikë ose privatë, që çmohet se kanë njohuri të posaçme për çështjet ligjore të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Këto mendime nuk janë detyruese për gjykatën dhe do të publikohen sidoqoftë në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

Në përfundim të këtyre procedurave, kur gjykata vendos për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, në vendimin e saj duhet të formulojë edhe rregullin e së drejtës për çdo çështje të shtruar për zgjidhje në vendimin e ndërmjetëm të marrë gjatë gjykimit të çështjes. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare është i detyrueshëm për gjykatat e tjera në lidhje me çështjet e ngjashme

¹⁰ Neni 316 i Kodit të Procedurës Civile

f. Procedurat paragjykimore

Një tjetër risi interesante lidhet me parashikimin e procedurave paragjykimore, sipas të cilave Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mund të vendosin t'i drejtohen GJEDNJ ose gjykatave të tjera ndërkombëtare sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, duke pezulluar në ndërkohë shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë gjer në marrjen e përgjigjes nga gjykatat ndërkombëtare.

g. Dispozita kalimtare

Në dispozitat kalimtare të ligjit ndryshues përcaktohet epërsia e rregullave të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me përbërjen e trupave gjykues dhe procedurës së gjyimit në Gjykatën e Lartë përkundrejt parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.

Gjithashtu, nëpërmjet këtyre dispozitave kalimtare sqarohet dhe qartësohet se, në respektim të parimit të sigurisë juridike, rekursët e paraqitura por ende të pashqyrtuara, do të vlerësohen për sa i përket pranueshmërisë së tyre në raport me parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Sabina Lalaj

Local Legal Partner
Deloitte Legal sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mobile: + 355 68 37 33 130
E-mail: slalaj@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.